

Nuhi VESELAJ

T H E R M E P U P Ë L

/vjersha të ngjyera me humor/

Prishtinë, shkurt 2000

Përkushtim

me falenderim:

gruas doravetë,

fëmijëve ish-studentë,

që i zu taksirati

sikurse i bardhë fati

që të lidhën situtël

me caqet

sikurse vargjet

“Ther me pupël”!

P a r a t h ë n i e

Përshtypja ime: vargjet, në veprën "Ther me pupël" të Nuhi Veselajt, kanë lindur në dy periudha kohore: në të parën janë ato që panë dritë që nga fundi i viteve '60 e gjithandej, në kohën kur mendonim që po gëzonim një liri, që mund ta quajmë të kushtëzuar. Nga koha kur në valët e jetës na bëhej se po na shkëlqen një shpresë si rreze nëpër valë lumi, por sakaq e përpinte vorbulli kanosës. Pjesa tjetër e vargjeve kanë lindur më vonë dhe gjithsesi janë përpunuar në këtë kohën e fundit, kur kemi zënë të gëzojmë fillet e një lirie.

Sidoqoftë, këto vargje fshikullojnë veset individuale dhe shoqërore të këtyre dy periudhave. Nëpër to merr në thua individi ynë dhe tërë shoqëria që për një kohë të gjatë ka jetuar me kutin e dyfishtë të moralit dhe mënyrës së mendimit, të shprehjes dhe sjelljes. Kur individi mat me dy kute, deshë s'deshë, na del një karikaturë (secili me karikaturën individuale) dhe nga ana tjetër na del një tablo tjetër - karikaturë e madhe e shoqërisë.

Autori, do të thosha që nuk therr vetëm me pupël, por edhe me vegsh, siç e thotë populli, dhe, duke therrur në këtë mënyrë, gjen, jo vetëm shprehje, por edhe satisfaksion intelektual për të vënë piketat e ngjarjeve të vogla e të mëdha në midisin tonë shqiptar. Dhe jo vetëm piketat por vë edhe gurë të gëdhendur të një temeli të ri, përpjekje kjo e të gjithë neve, si ta gjejmë veten tani që kemi dalë nga errësira dhe ende nuk na u kanë mësuar sytë me dritën e lirisë.

Edhe pse me vargje, libri është një kronologji e kthesave jo të vogla dhe buzëhëneve ku, deshëm apo s'deshëm ta pranojmë, gjallëruam. Nga një shoqëri patriarkale, na u sul si një re e errët emancipimi, pra si një shujtë që i urituri nuk di ta hajë me masë dhe ndodh edhe mund ta ngulfatë atë. Në këto kthesa ka hutesë, çorientim dhe teprime në sjellje si në familje, shoqëri e kudo. Dhe kjo shtjellë kohore askë nuk godet më shumë se të rinjtë që dendur edhe humbasin pusullën. Duan t'i ngjajnë kohës, por harrojnë që kohën megjithatë duhet matur me racionalizëm, me një fjalë: të emancipohemi, por të mos flakim tërë trashëgiminë pozitive, ndryshe do të bëjmë hope qesharake e të rrezikshme.

Autori iu ças këtyre problemeve me dëshirën që të japë kontributin e vet për të mos e brerë krimbi i ndërgegjës si krijues, në një anë, dhe si individ i kësaj shoqërie, në anën tjetër. Me një fjalë: "Të qorton ai që të don" - e thotë populli me përvojën e gjatë jetësore.

Libri ngërthen në vete drojën ç'do të bëhet me ne në këtë udhëkryq kohe: si të shkëputemi nga e vjetra dhe si ta përqafojmë të renë, dhe çdo e re, si në mënyrën e të menduarit dhe sjelljes sa dhe si mund të na zvetnojë si qenie?

Këto poezi spërkatur e vesuar me humor që i propozova me kënaqësi për botim, dëshiroj që tash si libër edhe për lexuesit të jenë të mirëpritura dhe të kënaqin kërshërinë e tyre.

Prishtinë, prill-2000

Me nderime
Rifat Kukaj

Parasqarim lexuesit

Parandjej, lexues i nderuar, se mund të vete buza në gaz, pasi të keshë shetitur nëpër titujt e kësaj përmbledhjeje e nëse ndodh e kundërta, dhe për këtë shkak nofullën e poshtme pakëz ta shtangon, pasi që nuk gjen asgjë të hajrit për vete, të lutem mos më fyej, se unë e kam paramenduar edhe këtë. Unë, në të vërtetë, në fillim pata qëllim të mirë. Desha të shkruaj shunt kundër shuntit e ndoshta grumbulluq mbeta në të. U bëra rob i kohës!

Unë, si me thënë, desha të pasqyroj diçka të vogël në botën tonë të "lirisë së madhe"! Më falni për sintagmën "të madhe", mbase për këtë nuk më jepni të drejtë, edhe pse ashtu quhej dhe që ende po quhet nga mjaft individë me peshë te ne, por sidoqoftë, për që rrojmë në një botë të konklavitur, këtë besoj se nuk do ma prishni, ngase kjo kohë jona në kokë t'i konklavitka objektivat, edhe pse ne mendjen e kemi shumë të shëndoshë! Pra, kjo që paraqitet këtu, është, në njëfarë mënyre, copë e vogël e pasqyrës së kohës sonë, pasqyrë kjo e thyer dhe e përthyer dhe e bërë copë-copë në vargje dhe se nga çdo pjesë a thele të saj, mund të shihet diçka nga tabllloja e vërtetë e realies së jetës sonë, sidomos në rrëfimthet në vargje nga fundi i kësaj paraqitjeje...

Dhe kjo si vepër u godit disi në shembëllesë, ashtu si bëhet të ngriturit e "kullave të fildishta", ku i vendosnim dikur "mondishat" e "fildishat", më falni, mondishet e fildishet" e kohës sonë adoleshente, pikërisht aty ku sot po vendosen vetë "modernistët", "hipikët", "bitëllsit", "drogistët", "feministët", "lezbejkat" e -istë e pistë të tjerë, ashtu sikurse "formalistët" filozofë e poetë, mbartës të artit "futuristë", revolucionarë, avangardist klasistë- markistë, ashtu siç po vendosen edhe mjaft kritikë letrarë që po jetojnë me lojëfjalësia, me të cilët gati s'kuptohet asgjë dhe pallatet e kulturës sonë i shohin nën tymin e kamishit dhe nën mjegullën e avullit të venës!...

E ardhmja sigurisht shumë maska ka për t'i çjerrë, po ashtu dhe ka për të vënë shumë të tjera, mbase aso karnevalëse!...

Ne, si punonjës e duam edhe këngën edhe lojën dhe në këtë kuadër i duam edhe fjalët lojë, edhe fjalët punë, edhe vargjet e gërshetuara në kohë... Prandaj unë këto vargje që shumica dalin nga "mbretëria e dashurisë rinore" ia dedikova, pikërisht kohës më të vlefshme për ne "zyrtarët": kohës për orët e lira", atëherë, kur intelektuali ynë pasi që s'paska me se të merret në punë, bëka plan se si ta kalojë kohës pas punës! Pra, pas punës pa punë, në mënyrë që të ketë sa më shumë kënaqësi e dashuriçka me fjalë si një pjesë e botëjonës avangarde të qytetëruar sot!

Kështu dhe unë u hodha pararojë në ballë të kësaj lufte të madhe "arratistike" që dhe ne të ngrihemi në piedestalet më të larta të kulturës evropiane që i thonë "dashuri!"... Dihet se për teoristët ndeshim në dashuri hyjnore dhe dashuri tokësore. Këtu ne në këtë përmbledhje ndeshëm vetëm në dashuri kotësore, dashuri e kënaqësi epshore (trupore, biologjike), dashuri shpirtërore (psikologjike) dhe dashuri shoqërore të interesave të mëdha (politike, shtetërore, kombëtare, internacionaliste, proletare, partiake) në shoqërinë tonë pa brenga, por me detyrime e të drejta të stërngarkuara që vështirë se mund t'i mbartim në kurrizin tonë shoqëror dhe më vështirë e kemi t'i gëzojmë, pasi që ne vetë ende, si duket, s'po mund t'i kuptojmë!...

Sidoqoftë, kjo vepër i dedikohet në radhë të parë periudhës së adoleshencës së lartë, përkatësisht periudhës së rinisë së vonë a të burrërisë së hershme, ngase për burra e me burra të vërtetë a me burrnesha s'kemi punë kësaj radhe!...

Përmbledhjen e pagëzova "Ther me pupël", jo ther me vegsh, ther me shajka, ther me gozhda, e ku ta di..., sepse vetëm pupla dhe miza ngapak gicilojnë dhe sakaq lëkurën nuk ta lëndojnë aq, sidomos atë të fytyrës nuk e lëndojnë fare, pasi që te ne s'ka njerëz të pafytyrë, më mirë me thënë, s'ka njerëz më fytyra të nxira, sepse po vënë maska e ato lahen ose hedhen si dofarë kallëpesh! Megjithatë ndodh mbase që në ndonjë rast të na shtojnë kromzën, por ç'të bësh, jeta i ka morrnicat e veta!

Fundja, lexues i nderuar, edhe pupla i ka dy anë që gjithkush i di, njëra me majë e tjetra pa të, njëra për të ngulë, tjetra për të lëmuar, sidoqoftë, kaq ma barti kaçiku!

Prishtinë, qershor 1971.

Me nderime,
Autori

P.S.

Lexues i nderuar, siç dihet, "Ther me pupël" (vjersha të ngjyera me humor) është shkruar, në robëri, si oponencë ilegaliste a si reaksion i brendshëm ndaj regjimit titist (sllavokomunist)dhe plagëve tona shoqërore, mirëpo duke pasur parasysht rethanat e sotme në Kosovë dhe ato në Shqipëri që në mjaft raste përkojnë paksa me gjendjen nga parasqarimi i mësipërm, përkatësisht me tematikën që trajtohet në shumicën e vjershave të kësaj përmbledhjeje, lënda mbeti pothuajse e paprekur, por natyrisht iu bë njëfarë përpunimi gjuhësor e paksa edhe njëfarë përzgjerimi e përplotësimi tematik. Hë për hë nuk e pashë të arsyeshme të jap sqarime për raste të veçanta, edhe pse e di se ato janë të nevojshme.

Sidoqoftë, mesazhi, që del nga pasqyrimi i realitetit historik ne kohëhapësirën e caktuar (qoftë në pikëpamje edukativo-mësimore, qoftë në atë politiko-shoqërore), mbetet aktual edhe sot e gjithë ditën, prandaj, lexues i nderuar, të dëshiroj lexim të këndshëm dhe besoj se do të kesh me se ta kënaqësh kërshërinë Tuaj, sidomos tashti kur Kosova ashtu si edhe Shqipëria frymojnë më lirshëm.

Prishtinë, shkurt 2000

Me nderime,
Autori

DOLLI ME BUZËQESHJE

E ëmbël buzëqeshja e foshnjes n`struka shtritur,
bukur tringëllon kënga e të dehurve të uritur,

por mbi të gjitha qëndron qeshja e të dashurve
kur joshen rrugicave si në sallone të t'pasurve!

Pra dhe ne për hir të ngazëllimit shpirt-ideal
të buzëqeshim me zor, të mbulojmë çdo breng e hall!

Dolli me buzëqeshje, dolli me këngë në buzë,
dolli me qerasje që të djegin në rruzë!

Dolli për festa shtet'rore, të aparatit të mirë
dolli për festa internacionale: demokraci e lirë!

Dolli me buzëqeshje për atë, për këtë,
por jo kombëtarizmave që u kemi vënë fre!

Dolli me buzëqeshje për mbretërinë e "dashurisë",
që del thesar nën mbrojtje të vetë qeverisë!

LUM E LUM ...

Lum e lum ç`na solli stina,
trumbetojnë bashkë gra e trima,
se tash po këndohet këngë e re
që jetëpunës-zemër i jep hare:
këngë për vllgun e dashnisë
që si uji që shkon visë
dhe loçkën tokës ia ushqen
ashtu ne ndjenjat na i rrëmben
dhe po na josh e po na mpin
po na njomë, po na përtërin...

Hop... e kap tash me sharki
t`dridhen telat n`qifteli,
se dashnia ku sundon
me gaz jeta shqim kalon!

E për trima atdhetarë
mjaft kënduam motit të parë,
e ne tashti si brez i ri
këndojmë jetojmë veç për dashni.

Ja, në akorde, n`festivale
si ndër fusha, kodra, male
melodi e këngë dashnie
jehojnë plot në këtë vazhdë lirie!...

NXËNËSI ME VETURË

-Zoti nxënës që ke veturë,
këqyr për toke, pak, bre burrë,
me jardam pak e teprove,
punët e shkollës i harrove,
me përçmim mos përshëndet,
pse ke "karro" s`je bërë mbret!

- Mos ma merrni me zili,
dua të kënaqem, jam i ri...
ma bleu prindi, bëri mirë
ma plotësoi dhe këtë dëshirë;
ma ka mbushur zemrën shënd
që t`mësoj më mirë e të mbledh mend;

tash s`po më zihet vendi vend
e zgjedh "zogën" shkoj "vikend"...
më doli zëri në shtat mahallë
mund të zgjedh "zonjat" me kokallë!
perspektivën e kam në grusht
për kurrgjë sot nuk jam ngusht!

Unë s`kam faj që profesori
der`sa u mplak, çoi jetë me zori,
s`qe i zoti të bëjë shtëpi
as auto vetes, as për fëmijë!

...Për të thonë se shoqëria
ia çmon lartë vlerat e tija;
ai ka dije, ka përvojë,
fatin vetë le ta provojë,
le të luajë profi lotari,
ndoshta blen veturë e shpi!

Hallku po fitojnë me "kuiza",
blejnë vetura me deviza
veç të profi ngeli kriza!

Për të mendjen s`dua ta lodh,
fokus-pokus mund të ndodhë
ishalla gjen pare me "kerr"
ishalla bëhet miliarder!

"ABSOLVENTI" I SHKOLLËS SË MESME

Kryet përperjet e duart në xhepa
shkel me sy për tungjatjeta;
n`shkollë të mesme mirë jetoi,
katër vjet rr'shqanas kaloi:
merrte notat ashiqare,
por për to s`mërzitej fare
libra s`kish, s`bënte ushtrime,
në bllok mbante ca shënime;
kështu na u bë njëfarë çapkëni:
fjalë e letra shumëherë endi:
te një vashë e te një tjetër,
u ndihmonte shokëve "të vjetër",
thonë se u bë si specialist
për të vënë unaza në gisht!...

...Ndihmoi kështu dhe ca "eprorë"
që t`u shkojë diçka për dorë,
ndërsa këta si partriotë
do t`ia falnin "ndonjë" notë...

Kështu bandillit nga përvoja,
për çdo vit i ecte ora;
po ky fati, ky farë dreqi,
eci, eci, në fund i ngeci:

n`provim të fundit, t`pjekurisë
s`u shit ylli i dashurisë:
komisionet s`depërtohen,
fals-punimet po diktohen;

tash tri vjet, po heq i shkreti
"absolvent" mbeti se mbeti...
t`i gjejë fajet shpesh mendohet
dhe në vetvete nervozohet:

-Çka u humb më nuk përtërihet
murit tash me kokë s`i bihet;
kokë moj kokë çka i bëre vetes
çove kot një pjesë të jetës!

OJ TI NXËNËSJA Ë SHKOLLËS SË NATËS!

-Mori nxënësja e shkollës së natës,
qysh i ra n'fije "nafakës",
pa krye shkollë e pa praktikë,
pa përvojë në politikë,
m'thuaj, qysh hype n'maje të plepit
dhe u bëre nëpunëse e shtetit?!

-Ti moj mësuese, daskallicë
që t'pret gjuha si sakicë,
që po shitesh se di shumë,
do punë eja mësoj tek unë;

veç me libra, me arsimim,
krejt e dinë, pak ka fitim;
ka shkollë tjetër më pak të vshtirë
mori mësuese, zonjë e mirë;

në daç nafakë, fitim të mbarë
mos i mbaj shpresat në ditar,
pare ka ku shiten bozat,
dhe më shumë ku çmohen pozat;

e për me u bë nëpunëse shteti,
çka po e shoh se t'bren hasreti,
përveç fatit e besimit
lypsët shkolla e sharm-grimimit

dhe për karrierë, moj daskallicë
veç njoftësisë vyen sakrificë?!

RRUGËDALJA E MENDJEHOLLIT!

Një shkollar me plot "elan"
mendon thellë për ardhmërinë,
prandaj sot po e bëka plan
si ta ndihmojë shoqërinë;

këtu nuk kemi "skotland jard"
as atelje holivudi.
ne s`qëndrojmë lart me standard
e si t`jepet, vallë, kontributi;

ç`mund të bëjmë, kur kompetenti
ndërmarrjen e vet e xhvosh
dhe kur të ligat ia merr "shenjti"
vallë, mund të thuhet vetëm "shëndosh";

çfarë t`u bëjmë të rinjve të egër,
që kanë sy, por s`ndjekin shkolla;
të papunët, lypsa, të verbër,
që të gjithë kërkuakan të holla;

t`luftosh fenë, s`del mirë hesapi,
s`di, kush s` pari lindi zotin (!),
sa është hapi lëshohet vrapit,
veç "Madhnia" ndryshoftë motin!

Pra rrugëdalja më e mençme,
është të shpallesh "feminist",
t`vështrosh gocat më të lezeçme,
mund të jeshë "hipi" o "snobist";

se shoqëria jonë s`ka halle,
nuk ka plagë, as nuk hap plagë,
të rinj e të reja të hidhen n`valle
dhe kur punëtorët s`marrin pagë!...

BRUCOSHI BOSHKOHOR

Iku koha, shkoi një vjet
qysh se e mor emrin "student",
kishte sjellje: qejf për unin"
s`ndjeu për prindin për katundin;

dilte shpesh, n`fresk, në korzo,
shkonte n`kino dhe në ballo,
në kafene, thonë, lypte "paste"
barkun bosh e të tjerët qeraste!...

nganjëherë sa për "idare"
pinte "dopio" e "kent" cigare;
thonë, pa pije e lojë kumari,
puna fare s`ecën së mbari;

pa bixhoz e narkotikë
thonë, s`ka të mbarë as n`politikë;
pa boks-meç, xhudo, karate,
s`mund të shpallesh "hero nate";

pa bit-frizurë a hipik trenti,
s`mund të jesh "dasë" - yll oksidenti?!...

Kështu mësoj djali tërë një vit
por si Verteri s`u vërtit,
me "mençuri" në bllok shënonte
jo për shkencat që studionte,

por për ato damat bukuroshe,
plot me sharm, shikime joshëse
që si goca bashkëkohore
din të buzëqeshin si "dashnore",

ndërsa mësimet, si t`ju them,
në provim pak iu bën ujem:
ikte i tretej çdo afat,
s`i ndihmoi i shkreti fat,

prandaj humbi, por s`ngurroi:
fakultetin, thonë, e ndërroi,
bursë e babë, thonë, i gëlltiti
porse vetes shumë zë i qiti:

e quajnë "brucoshi boshkohor",
po veten prap do t'marrë në dorë,
sepse ka marrë mësim shumë me vend:
bursë e babë me i vjelë me mend!

NJË VAJZË E EMANCIPUAR

Jam një vajzë mejtepli,
di të buzëqesh me mallë të zjarhtë,
njuh mjaft gjëra me rëndësi,
çdo gjë n`jetë e kam të qartë;

di të ec porsu artiste,
i lidh flokët kalabisht
jam për art specialiste
rekordmene e shumëfishtë;

bëj masazh, përdor mirë shminkën,
si më e mira në qytet,
njuh mire tenin, kozmetikën
jam e zonja: doravetë;

sa për shkollë, mos pyetni fare,
femrës dihet i pjell mendja,
ajo e lirë sot nëpër "bare"
e shpreh zjarrin që e kall brenda!

"KËSHILLË" PRAKTIKE

Vashë, hiq mrrolën ballit,
keq kurrë mos kujto,
n`gaz kaloje jetën,
rini s`të vjen kurdo;
largoje pikëllimin,
vishu disponim,
ruaje shqim buzëqeshjen
dhe në çdo zhgënjim;

fuqinë e shikimit
ta mësosh e fitosh
që veç me sy trimin
t`mund ta robërosh;

nëse zgjedh buzëqeshjen
që shkrep me magji,
do ta keshë me vete
tërë një mbretëri;

gjithashtu t`ka hije
të keshë shikim krenar
mund të luajsh maca-miu
me çdo djalë beqar;

nëse je nëpunëse
palët leji të presin
që sa më gjatë që të shohin
zemrat t`u ngërdheshin!

HAK PËR HAK

S`jam i mjerë më me t'u lutë
për mëshirë, moj hijerënde,
kam marrë zemër, hiç pa u tutë,
se nuk jam më në dorën tënde;

e pranoj se përvojë s`kisha,
isha i tretur në të largtat vise,
ti më ngacmoje s`t`vinte marre
dhe më rrëmbeve, më përmbyse;

tash, pra, unë sa erdha në vete
pa zhgënjim shoh dritën time
prap në ty shoh lakmi jete
dhe të lartësoj, po pa teprime;

tani vërej se dhe ti tek unë
vëren ca rreze që po të zënë,
pa nevojë që të përdoret dhunë,
leqet tuaja n`"shtos" t`kanë vënë;

njëherë të lutja tash më lut,
e sheh si jeta dallgë - dallgë ndërron
mos ia bën t`zezen dikujt
se pa mëdyshje vetë e pëson!

LOJËFJALËSH

Lum kush di të flasë
lum kush di, dëgjon
gjuha është një masë
urtia kur peshon;

lum kush di të flasë
dhe lum kush dëgjon
goja kur të shklasë
këmba keq e pëson;

dihet se me fjalë
sarajet goditen,
dihet ca të rinj
me to koloviten;

ca mendojnë se ngrohen
me disa fjalë të larta
dikush miq'sinë ntrashka
veç me fraza të thata;

s'vlejka mësimi i vjetër
se veç me fjalë të thata
s`bëhet asnjë vepër
s`pranohet as urata;

ngase sot me fjalë
sarajet u goditkan
ngase të rinjtë e të rejat
me to u kolovitkan!

MIQËSI E KUSHTËZUAR

Mirëkuptimin, dashurinë
der'sa e gjeta hoqa keq,
por kur do Zoti t'ndihë njerinë:
n'vend kulaç i jep përpeq;

ashtu dhe mua një buzëbrëmje,
m'u bë zemra mal atëbotë,
se takova kë e desha
thashë: ah, e lumja ime botë!
E takova në një qoshe,
një loçkë droçkë, një përri,
shpejt e lehtë dhe u kuptuam
që të lidhnim një miqësi:

miqësi të shenjtëruar,
dashuri si lule prilli,
dashuri nur të pashuar
dashuri për kupë bandilli!

por s`shkoj shumë më vuri kusht
që e pranova pa rezervë,
me fjalë të mia më zuri ngushtë
palpaluc si peshk në konzervë:

ajo më tha; -Sa të kesh shëndet,
do të më duash vetëm mua
e po bërë u sëmure
unë dhe tjetrin mund ta dua!-.

Dhe kështu gjatë s`më eci zari
më ra gripi ai flamaç
dhe "fisnikja", iku, s`priti:
as "tmirëmeç", as "tëmbarëpaç"!

AH KJO FORCA INTEGRUESE!

Shikimet kur gërshëtuan
faqe fytyrë iu skuqen
zëri u doli çudshëm
dorën me dorë sa u puqën;

kështu tashmë u njohën
s`vidhen më me sy,
por gulfin më të madh
mbeten pa e shfry`...

se asnjëri s' paska
për qerasje të holla
dhe pa para dihet
s`hip n`minare hoxha!

Duartë s`u bëjnë më punë
shikimesh u tretën
fjalët disi u humbën
zemrash u lëmekën,

por s`shuhet dot vullneti
kur të vijë mirëkuptimi
edhe pa para fare
pranohet integrimi!

Kështu dhe dy ndërmarrje
që humbje prore pësojnë
për të mashtruar punëtorët
punët integrojnë!...

Kështu shkëlqen veprimi
me interes reciprok
gjen jetë integrimi
kur shoqja gjen një shok!

HOBII I NJË "AKADEMIKU"!

Ec e ec mbërriu bukur lart,
tash ndjek mësimet në fakultet
s`beson zot, as s`beson fat,
fat e zot ka në dorë të vet!

N`kohën tonë ngjajnë mrekullira
mahnit shkenca e di njeriu
ta merr mendja se këto të mira
s`vijjnë pa punë, prej vetvetiu!...

Kështu dhe ky si i ri modern,
mësoi punoi dhe fitoi "hobe",
jo për stripe, shunt "uestern"
por për "foto - revii mode":

nga revistat bën "album"
gjen e pret fotografi,
lakuriqet i do shumë,
ato n`jetë sjellin freski!

Kështu i riu "akademik"
jep ndihmesë tue pre syreta
dhe n`vijoftë kështu, tepër vrik
ka me shkruë për të gazeta!

GJURMIM SHKENCOR!

Në pyllin lisagjatë
vashë e djalë u gjetën
rrijnë vështrojnë natyrën
dhe n`mendime treten.
- Fërshëllinë e lehtë
ndër gjeth` u dëgjua!
- Pëshpërit puhia
për ty e për mua...

Bisedën vazhduan
për barnishta, fleta,
si lules së vetmuar
këtu iu tretka jeta!

-Vallë, këtu jeta lules
a mund t'i sigurohet?
-Vallë si mundet rrezja
degësh të përbirohet?

Hipur në krahë të shkencës
këta dy të rinj mejtojnë
dhe me sytë e mendjes
mrekullitë gjurmojnë!

Tjetër herë do të shpikin
dhe çështje me të mprehta
për lule, për hije,
për rreze, për fleta?

MOSPËRFILLJE

Bora bie mbi flakë
gaca fshihet në hi,
tymi ngritet lartë
dhe humbet me lebeti!

Porsi zjarr i shuar
zhduken plot kujtime
të vajzës së dashuruar
të zhytur në zhgënjime;

dashuroi një ylli,
kujtoj se jepte dritë,
por ai si gjethe pylli
humbi, u venit;

kur kjo me tërë afshin
e dashuroi ngrohët,
ai iku pa "'upafshim"
pas një puthje' t'ftohët!

-Qysh u prish kështu vendi,
s`ka "razi", s'ecë puna,
ku është kompetenti,
pse s`përdoret dhuna;

të përdoret dhuna
dhe për dashuri,
që në mes të të rinjve
mos të ketë paqartësi!

PËR LAKMI

Vajza i hap krahët
djali qesh ballhapët
drita në mes venitet
afshi rritet, rritet;

ja çasti i përgëzimit,
kush sheh e heton
s`mund ta shprehë njeriu
çka jeta dhuron?!

Këso skenash të rralla
mund të shohësh shpesh
në ekrane të hapta
që t`rinjtë t'marrin vesh:

se sa lart arriti
shkenca e artizmi
dhe si peshë na çon:
dashni komercializmi!

SHPIRTI I PËRGJUMUR

Djaloshi ëndërrash
dashka gjumin shumë
për hir të ëndrave
që i rrjedhin si lumë!

-I dua,- thotë,- ëndrrat,
se më bëjnë të qetë
ma shërojnë kokëdhembjen
dhe këtë zemër t`shkretë!

Vallë, çfarë ka djaloshi
ç`janë gjithkëto t`pamira
pse të vuajë i riu
në ditët më të mira?!

Djaloshi, s`përgjigjet
përqart flet më shumë:
-Gjumë, -thotë,- dua jetën
ëndrrat t`rrjedhin lumë,

se një vashë që e desha
në këtë botë "reale"
iku, treti gjetiu,
mua s`ma vari fare;

kështu tash nga merak
lumi i zi më mori
po m`luajnë mendt e kresë
po m`rrah depresioni!

FILOZOFIA BASHKËKOHORE

Djem e vasha, disa koka,
në çdo kohë e në çdo vend
për standard e si ndërron moda
bisedojnë e vrasin mend:

moda n`veshje, moda, në fjalë,
stili i vjetër, stili i ri,
ua kanë bërë mendjet vërdallë
me këtë të re filozofi;

filozofi për dashuri,
gjë që nuk ndryshuaka kurrë
se çdo njeri e mbart në gjji,
qoftë grua, qoftë burrë!

Tani n`modë është t`gëzosh jetën
se "liria" sollli të mira,
liri fjale të vërtetën
dhe për gusha shumë stolira!

Po kënaqësi intelektuale
a ka kund, rrëfëhet vështirë,
prandaj kokat ideale
shtrihen shlirë edhe më mirë:

kënaqësi, thonë, mbi kënaqësi
si stolisje më e shrenjtë
është të mpeksesh n`dashuri
kur Orfeu i dredh penjtë;

dashuria për shkollë-mësim
ca të rinjve u duket barrë
më mirë në disko për argëtim
sesa dije, thonë, me marrë;

dija shumë t'i zbardhka flokët
prandaj mësimi më pak vend
arsyetimin e japin shokët
që edhe ata kanë tepër mend!

ÇIFTI IDEAL

Deshi fati na bashkoi
një na bëri na bekoi,
elementet bënë lëgurë
ne u bëmë të pandarë kurrë...

-Po t`i fare s`më dëgjuake
vasha të tjera po shikuake?!

-Jo moj jo, veç ashtu të duket
xhelozia tek rri struket;
fajet syve u takojnë
pse gjetiu ikin shkojnë!...

Sytë e tu si sytë e mi
duhen mbyllur thellë n`kuvli!

BASHKËSHOQJA IDEALE

Ky pushteti i dashurisë
është i fortë sa s`ka kufi
e kur në qafë i bie rinisë,
plandos, lëmek, si me magji;

dhe djaloshin tonë e zuri
papandehur në kanape
dhelka trupit shumë i pruri
dhe kujtime plot hare;

dashuria s`bën të ndryhet
duhet të shfaqet botërisht;
ndjenja e ëmbël mëkat të ndrydhet
duhet shprehur krejt lirisht!

Kështu dhe ky si "don zhuan"
zu të kërkojë ndonjë vashë të re,
por ç`t`i bëjsh këtij t`shkretit xhan
s`ia dashka asnjë, për be!

Tërë atë mallë, vallë, kujt t`ia shpallë
se në dheun tonë, nuk gjetka femër,
që i rri afër këtij farë ylli,
qoftë për dukë, qoftë për emër!

Por s`lë fati shumë të vuajë
s`është e zezë kjo jetë jallane,
s`shkuan shumë ditë, s`u bë as muaj,
gjete shopen pa behane:

gjete pra një për shtatë gjaqe
me sy të ëmbël e gazmor
që në revistë kish zënë një faqe,
pamje e bukur ish në kolor!

TERAPIA

Po vuaj nga kompleksi,
të lutem, më shëro,
s`ma kap syri, veshi:
çka zemra ma do!...

halli më ka zënë
më bëri mishmash,
gjëma më ka rënë
veten po e humbas!

Vashë je apo hije
që më bëre vesves,
më lejo në mes të gjinjve
ta vë këtë vesh;

përse, mos pyet fare
se unë ta them: *bam*,
hapur lypsi qarje,
aq gojëmarrët nuk jam:

dua zemrën tënde
ta hetoj si shket,
dua frymën tënde
ta kuptoj si flet...

-Ndal, mos u ngut,
ta them një terapi,
gjuha e zemrës but
shprehet në dashuri;

buza e mëson buzën,
kur puqen ndërveti,
kurseji gjiun dhe gushën
kompleksi do të treti!...

ILAÇI I DERTLIË

Me sy po kërkuj
cakun për të pushuar,
kam lulishten pranë
me gjelbërim praruar;

bredh, gjezdis, s`ndalem
s`më zë vendi vend
dhe si foshnjen gjumi
diç më kalamend;

zemra më rrah çekan
fytyra më ndizet flakë,
dridh qerpiku i djathtë
mbase del "nafakë"!

Dhe vërtet në çaste,
të thuash më "kritike"
një loçkë kërkoi leje
të ulet në karrige,

kështu gjumi më iku,
kalamendja më treti
zemra e lënduar
"mehlemin" e gjeti!

ZGJIDHJA FATLUME

Jeta është fabrikë,
njeriu si makinë,
t`vjen amortizimi
kur ta humbsh fuqinë;

pas akumulimit
sërish energjia
vërshon, duket qartë,
s`do mend, te rinia;
në dallgë e në valë
të lumit të jetës së vet
si të mësojë not i riu
para se të futet n`det;

ja sot konkretisht
si të veprojë "dasa"
ka alternativën:
ja libri, ja vasha!?

Dhe s`ia kap dot truri
se me orar, me rend
gjendet kompromisi:
për të dyja ka vend:

kompromisi në jetë
është zgjidhje fatlume
prodhimi në fabrikë
s`duhet të ketë humbje,

çdo shkollar i lartë
bën një të madhe punë:
kujdes i vë librit,
vashës dhe më shumë!

Kështu pra kompromisi
si një mjet shoqëror,
po shfrytëzohet n`shkolla
dhe si mjet shpirtëror!...

KOMPLIMENT PA KOMPLIMENTE!

(dialog)

-Vajzë hyjneshë,
ty vetëm ty po t`i fal thesarët
e mësheftë të zemrës sime,
se ti vetëm ti, më buzëqeshe pa djallëzi,
kur të thashë se vetëm ti je lule,
je nektar virgjëri!

Ti virgjëreshë,
edhe pse je shenjë e shigjetave të mia shikime,
je natë pushimi ku shlodh sytë e ëndrrave të mia
je shpresë e lindur për ardhmëri
je virgjëri, je më e pastra dashuri!

Fundja, shpirte,
çfarëdo që të jeshë
qofsh e bardhë e n'brendi e zezë,
jetës m`i dhe jetë, trupit mish e gjak
dritës m`i dhe shije
shëndetit shëndet, zemrës lavdkrenie
punës hov risie...

Virgjëreshë, moj hyjneshë,
të drejtohem, merret vesh
se për mua je model
për pikturën më me vlerë,
për ndjenjat më të ëmbla që thuren në vëgim
prej fjalëve më të yndyrta
prej ngjyrave më të ngjyrta;
je burim i komplimentit frymëzim
je vetë komplimenti për jetën adhurim!

-Kompliment pa kompliment
mos m`i luaj, djalo, mend e kresë
kompliment pa kompliment
mos ia rruaj shumë qimet vesë!

Thuajmë haptas, për të thënë ç`ke
se hyjnesha s`ka më ndër ne,
po ka xhane, shpirteforta
që i mba buka me kore të forta!...

DIALOG POETIKIST!

Poeti:

- Sa të shlodh gjumi, pasi të pushojë dhembja,
më shumë dëshira mund t'i plotësojë ëndrra,
po dhe më shumë të ëmbla përndahen nga zemra
vashë, moj e bukura vashë!

vargjet më të vlerta dalin vetvetiu,
vargje këto virgjine si gaz çilimiu,
vargje me forcë të rrallë erëzim njeriu,
moj vashë e shtrenjta vashë!

Sot për ty u zgjua një botë e tërë
sot tek ti syri sheh vetëm pranverë
nga ti amshimi krah të rinj po merr,
vashë e shpirtit vashë!

Vasha:

-Djalë poet, modern - bashkëkohor
nuk po them se s`po t`marr në dorë,
për ty shpesh përbehem unë
se je bërë o lum për lumë,
mos kujto se me boshllafe
sot mund të pihet ndonjë kafe;
me pak zjarr e me shumë tym
nuk vlon uji, jo, në gjygyim,
s`bëhen jo petulla me ujë,
s`mblidhet sana pa grabujë;
sot flet parja, flet florini
treqind qese një birë mini!

Poeti:

Jo moj jo, moj e lumja, vashë
që herë të shoh të hollë e herë të trashë,
me politikë unë nuk hy në valle,
aty lypset pare e madhe;

unë s'kam pare, por zemër trimi,
ku nuk shihet as birë mini;
unë kështu desha me bosh llafe
t`laj filxhanat pa pirë kafe!

HAPET E DASHURISË SË MPIRË!

Dhembje shpirti ndjeva unë,
s`mund të bëjë as një sy gjumë,
marr do hape, them të pi
që t`më ikën kjo sekëlldi!

kokrrat më dolën dy farë soje:
do pelim, do mjaltë - hoje...

të ëmblat qenkan maj-sheqeri,
m`pushuan dhembjen menjëheri,
thashë, lum-lum, më buzëqeshi fati,
s`bën të vuajë gjithmonë krahëthati,

por ... kur desha ta shtoj gazin
vetvetes ia dhashë marazin:
hapet e tjera më dolën djegëse
m`i shtuan trupit ethe ngjethëse;
them, ç`u bë me trupin tem.
futa zjarr apo mehlem
a sheqer apo majuf`lle,
ilaç shpirti a plumb-pushke!

Me këto hape e kam pak vështirë,
s`di a treten me pak hirrë;
thonë se helmin tretka hirra
dhe i kthjelluaka mendt e mpira!

Po tash ndër ne s`po gjendet hirrë,
prandaj mbeta mendjempirë!

LOTËT E BURRIT

Burrit ia pashë lotin
shkakun s`po ia di,
ndoshta e grin jeta
që është helm i zi;

burrit i del loti
mbase dhe nga gazi
se loti mund të dalë
kur tretet marazi!

-Nga gazi a marazi,
pse u mverejte burrë,
ç`tronditje t`pllakosi,
kështu s`të kam parë kurrë;

ndoshta qan të kaluarën
që dregëza të dha shumë,
mbase qan të tashmen
që të hodhi në lumë!

-Jo mor dost i mirë
s`jam burrec, po burrë
për hallet e jetës
unë s`çaj kokën kurrë,

por sot rëndë e pësova
"loçka" më ra sh'plakë
pse i thashë me të qeshur:
ke nisë pak me u plakë!

MENDJERËNDA

Vashat lule mendjerënda
mezi presin të vijë mbrëmja
dalin në korzo, shëtittore
krahpërkrah e dorëpërdore

tash nuk është si në kohë plaka
kur në thes futej "nafaka";
sot s`është drojë, nuk bëhet nami
pse t`vjen n`shpi bandill-jarani!

Por disa si pleqt jetuakan
kanë guxim të kritikuan!

Dihet tash s`jetojmë ndër male
po në qytet ku ka dhe "bare",
femrat dalin krejt pa havale
shesin "mallin" ashiqare.

Dhe n`për rrugë, zyra dhe shkolla,
vashat dalin me këmisha t`holla,
me jelek me minifunde,
për kulturë kanë librat shunte
marrin pjesë dhe n`festivale,
revi mode, maskenballe;

ua, sa punë kryejnë vashat-lule,
hijeshojnë ballot, çdo kënd rruge!
Kush s`e do këtë bukuri,
kush nuk mbushet krenari;

janë këto vasha mendjerënda
mezi presin sa të vijë mbrëmja
e për ato veprat e "idealit"
duket mjegull maje e malit.

ME DY GRA

Njëra mollë
e tjetra shegë;
dy dashnore
ma bënë zhegë!

patën shije,
më marrshin të keqen,
se të dyja
ma vunë kleçkën!

shegë e mollë
deshta n'harem,
që t'i shtrydh
t'i thith mehlem,

por llaskuçet
m'çelën plagë;
ma bënë zemrën
vija - vrragë;

njëra shegë
e tjetra mollë,
njëra gjarpër
tjetra bollë

më helmuan,
më nxorrën jashtë,
kjo lakmia
dritë mos pastë!

AH, KËTO ZËNKAT!?

-Puhia miklon ballin e lodhur
ëndërrimi ilaç për zemrën e vrarë,
këto janë probleme,
për të cilat duhen fjalë?

-E dashur, heshtja jote argjend
fjala jote, ar margaritar, e shtrenjtë
por unë do të zgjidhja
heshtjen si gjënë më të shenjtë!

-Margaritari dërgohet në fabrikë
që të spastrohet nga ai llumi i lig?

-Aman moj zemër, mos me boshllafe,
mos më fik, eja të pijmë kafe!
se druaj më bie ajo e tokës
e mos të bëhemi gaz i botës!...

-Nuk po më pihet, kafe bën vetë,
fjala ime pse po të vret;
më s`do të flas as mos me më folë,
mos rrit mendjen se ke do shkollë!

-Grua, moj zemër, ik shakasë
mos më bën kështu me plasë,
nënë-vjehrrën, moti s`e ke ftuar,
për drekë, çka na ke gatuar;

mos me zënka, mos me garez
se na shkon jeta për faqe të zezë;

zënka n`shkollë, zënka në lagje,
në vend të punës në sokaqe,
në kuzhinë, në dhomë të fjetjes
zënka: një plogshti e jetës;

a s`është më mirë t`ikim n`katund
mbase atje zenkat marrin fund;
atje, gruaja s`bën gëk me gojë
se del ai stupci që ta urtojë?!

-Ua, për zënka, falë mos të qofsha
në fshat janë mbushur pleme e kosha!
tash s`po mbahem me asgjë tjetër
veç me zënka të rinj e të vjetër;

zenka n'drekë, darkë e n'syfy
a di, goja, dot, nuk mbahet mbyllë!

SEDËRGRISURA

N`cepa të syve vazhdimisht
po i vë vijat ngjyrë teget
parisienet për këtë shkak
mund të më bëjnë mua hasret;

pror` vë shminkën, nuk harroj
e ruaj tenin fort nga ajri;
i vesh teshat më të pastra
që s`valohet kurrë te zjarri;

thonjt të paprerë, me llak i lyej
duart i mbaj të buta fort;
kam kujdes të jem e freskët,
prandaj punë me dorë s`prek dot;

unë kam dhe të mira të tjera,
gjoksin plot, gojën llokum,
po ç`të bëj po m`nevrikos,
një lahper, një horr, një llum!

Llumi i keq, he i raftë murtaja,
më ka vrarë veç me një fjalë,
ku është ai zot që t`ia thyejë qafën
qifti i tij s`bën të mbesë gjallë!

M`tha me lajka, me nënçmim:
-Je e bukur, mori mike,
por po të them, ashtu në besim,
s`je sharmante, je "frigjide"!

Epshe e gjak kam mjaft në vete,
buzët kuq, faqet kuq kuq,
ma marrtë t`keqen ai lahper,
ai flamaç, kërriq, marruç!?

Çka di ai se çka është sharmi,
çka di ai ç`është dashuria
ç`është e bukur dhe tërheqëse
he m`i marrtë t`ligat e mia!

FRYMËZIM PATETIK

Kur vegimi im poetik
përshkon bilbilin në fole
ai do të thurë çka s`thuret
melodi dëshpërore
pa shënd e hare!

Kur vegimi im anemik
plandos pëllumbin fjetur
ai do të rrijë i stërmekur
n` hingirizje marrëzore,
pa gaz të magjepsur!

Kur vegimi apatrik
mpleks frymëzimin patetik
diferencimi cilësohet dhunë
me ngjethje mjeshtërore
në planin politik!...

Kur patetizmi frymëzim
puq sytë e mendjes tapë,
vegim këngëtim shprehet
me ngërdheshje dëshpërore
në vargjet e djersitura, vapë!?

DIETË FRIZERE

-Bëje djalë, frizurën çikë,
lëshoji floket dhe një përçik;
lidh bistekë dhe vër karmin
me çdo vajzë do t'keshë takim!

Kështu thotë moda, mëson floktari,
rrofshin çunat, rroftë dollari!

-Dëgjo vashë, stiliste mode
preji flokët mirë rrumcalli,
se ashtu do të jeshë më joshëse
ia merr mendjen çdofarë djali!

Rrofshin çupat, rroftë dollari,
kështu lyp moda, mëson floktari!

LETËR MIKUT

Do t`i shkruaj letër një miku
s`ka pse shet më mend baltiku:
kemi ne seks-edukatën,
shohim ditën, shohim natën!
edhe te ne këtu në Ballkan,
jemi të fortë, pa "presedan":

zhvilluam shkencën me teknikë
çojmë "amore" me taktikë;
kemi mjekun na këshillon:
për ilaç, kontracepcion,
por po të mos ishte "abortusi"
s`na bart lumi, s`na nxë pusi;

Po lulëzojmë, po ecin para,
lumet vashat tash fatbardha,
por dhe djemtë gjetën t`vërtetën
sot askush s`e mbyll vetveteten!

Këto të mbërrime, sihariq
s`kam pse i shkep ndër shokë e miq!
se tash jemi shumë më modern
s`shikojmë aq filma uestern;

tash kemi porno mjaft në ekran
ditë më drekë e në aksham
në çdo skutë, në çdo kafene,
përparuam se ç`ke me ne!

NJË I ANKETUAR

-Ecja rrugës i shkujdesur
si në det hallesh kur noton,
kur papandehur para më doli
një "gaxhi" me mikrofon.

-Shok të lutem, apo jo,
ti që bredh qytetit kot,
a s`të vret ndopak diçka
që mungesë e kemi sot;
s`kemi hiç lule e gjelbërim
shenja këta për qytetërim;
çfarë mendon ti për standard,
turp të vishet rroba e vjetër
rrugët e ngushta për vetura
po mungon dhe ndojgjë tjetër?!

-Mos m`qaj kokën me kopalla,
po këto, fare, s`më ha palla.

- Po si mos të vrasë pak mendjeshkreta
që në nën këmbë po na shklet jeta?

-Them, jaran, mos ma nxir gazin,
unë me hapa mas pazarin,
s`kam me ble, s`kam me shitë,
por s`e kam mendjen me u mbytë;

ndoshta më del ndonjë nafakë
shpesh ndihmoi ndonjë grua-plakë
i bart plaçka: pula, këndeza,
m`japin rroba, të bardha të zeza,

nga njëherë edhe ndonjë pare
kështu fitoj sa për idare.

Sa për gjelbërim e lula shumë
i kam lënë moti n`katund;
këtu n`qytet s`po shoh aq zi,
ashtu si po të duket ty;

bindesh vetë muzgu kur të bijë,
në këto rrugica me shumicë,

derdhin ndjenja dashurie
gaz e vaj përzihen spic!

HALLËFSHATARKA

-Tash që erdhe, lum ti motra,
vishu mirë, mos t`qeshin bota
edhe mësona ne në katund
qysh t`i japim vuajtjes fund!?

-Ju fshatarkat gjithherë vuani,
se nuk dini të jetoni,
kështu me mjete primitive
kurrë nuk mund të përparoni;

...s`njihni kursin e dollarit,
konkurrencën, integrimin,
devalvimin, revalvimin
as *intencën: -socializmin(!);*

kur në qytet ecet me kohën,
ju haber s`keni për modën,
s`bartni, *mini, midi, maksi,*
s`kini *karro, auto-taksi;*

s`dini as për *revy mode,*
dancing-klube, hotelbare,
shou-muzike, maskenballe
as për *shfaqje-karnevale!*

-Gjë s`marr vesh, e mjera unë,
shkolla qenka e rëndë shumë,
xhevahire gjithkëto fjalë,
por mua mendjen ma bënë dhallë;

hajde tash, ndihmo, hallë plakën:
copto dru, qerepin nxeje,
ta qesim një misernike
se vijnë burrat, s`qiten kreje!

APELI I NJË PARTIAKU TË LARTË

O ju të rinj, aktivistë,
eni bëhuni komunistë,
që të fitoni të drejtë të plotë:
pushtetmbajtës për jetë e mot;
nuk është vështirë sa për fillim,
me u dhënë fjala me betim:
për Titon- Për Partinë
Socializmin Jugosllavinë!
Pastaj për Vllaznim -Bashkim
Atdhe, Parti e Përparim!

Me këtë dihet, s'mbaron puna,
për t'u zbutur pakëz dhuna
dihet mirë se në komunizëm
duhet shuar çdo nacionalizëm,
s'ka kombësi, as shovinizëm;
s'ka për ju më hoxhë as fe
s'ka me shkue n'xhami, n'teqe
s'ka as zot që t'i përulesh
veç *n'luftë klasash* të vërsulesh:
kundër armikut, reaksionit
kundër kanunit, kundër zakonit;
me këmbë duhet shkelë traditën
s'duhet folur më vetëm shqipen;
më mirë me "nashkë"modernohesh
veç me të mund të përparohesh,
me pi raki t'mirë shlivovicë
me i mësue shkronjat qirilicë?!

Dhe diçka qeshë tue harrue
po në dashit me u martue
si partiashë më lehtë e keni
vajza të vendit mund të zgjedhni;
merrni pjesë si vullnetarë
në aksione në atdheun mbarë;
atje gjeni të buta, të lëmueta
goca t'lira, të dala, të shpluta
më mirë serbe, malazezka
në daç bardhoshe, ndaçi të zeshkta
se këto tonat prapanike
ende s'dinë, janë fanatike,

me ato të tjerat është më mirë
më lehtë hapet perspektivë.
Kjo është rruga për karrierë
për udhëheqës, për oficerë,
profesorë me famë, doktorë
me rrogë të majme si drejtorë.
Kjo është rruga e shpëtimit
e socializmit, emancipimit.
Kështu do të bëhi të modernuar
politikanë të adhuruar.
Me patriotizmin jugosllav
do ta shërohet çdo shpirt skllav,
që shumë vjet këtu ishte mjellë
që kur m' kujtohet më vjen të vjellë!
Dhe në fund ju them një gjë,
kombësisë duhet me i dhënë fre,
Jugosllavinë kemi atdhe të parë
por si komunistë dhe proletarë:
atdhe kemi dhe botën socialiste
internacionalen komuniste!
po keni të drejtë me u shkruar *shiptar*,
jugosllav a tjetër farë,
po më mirë turq a goranca
a kurrsesi shqiptar-allbanca
po në daçi boshnjakë a maqedonë
se ashtu pazari sot po e kërkon.
Po kush do punët me i pasë më së miri
le të marrë dorë te komandiri!

Kështu ju mësoj unë luftëtari
veteran ish bir shiptari(!)
që tash ka poste mjaft të larta
në Beligrad te Federata,
ku atje ne kryeqytet
po e çoj jete fort me lezet
që di të shkruajë mirë qirilicë
që e nxeh barkun me shlivovicë!

LUTJA E NJË DREJTORI

O zot, të jem falë,
pajtoma ndërgegjen,
ruajma, zot, veturën,
ruajma zot fotelen!

punët e ndërmarrjes
le t`i zgjidhë stihia
e kah politika
t`më shtohet fuqia!

Falmë, zot, poltronë,
që s`ma prishin tymin,
kështu që fjalëve të mia
veç ua thonë "aminin"!

Dhuroma, zot, fjalorin,
t`mirë sekretarëshën,
mos m`i shto zot rrudhat,
t`rri gjithnjë hareshëm!

Kontroll mos më dërigo,
pos ndonjë dekoratë,
kështuqë në këtë drejtim,
mos më lër duarthatë!

E "vetëqeverisjen"
n`letër shtoje zot,
se shumë gabime tona,
aty fshihen sot.

Ca t`rinj, me diploma,
zot t`i keshë havale,
ndihmomë, zot, ndihmomë,
të çoj jetë pa gajle!

HALLET E NJË SEKRETARESHE!

Sekretaricë jam, po kam halle
kush më shanë zotin havale;

edhe unë kam, bre, brengat e mia
nën prapnicë m'dridhet *skemlia*;

këtu nuk rrihet për pikë të qejfit
po t'u shërbej palëve e më shumë shefit;

e di, shumë palë këtu vijnë nga derti
me gjetë qarje te kompetenti,

po ka edhe të tillë kapadai
që vijnë, për qejf, kafe me pi,

madje raki të valuar lypin
me ngrohë gushën, me nxeh fytin;

kur t'më vardiset ndonjë "trim"
e heq qafet me trillin tim;

atëherë shefi po m'quan xhanjoshe,
m'shikon n'sy që i kam kaltëroshe,
dhe mua atbotë po më hyp vullneti
s'më dhimbset kurrnjëfarë hyzmeti;

po dhe ai shpesh s'po m'rri n'besë
bën shumë gafa e s'kërkon ndjesë!

dhe sot me një shok pejdah
me hesap doli me lypë *gjah!*

kur i thashë: - Ku shkon ta di?!-
më tha: -Nuk të jap ty llogari,

unë të kam, xhan, sekretaricë
jo trupprojë, as gazdaricë!

Prandaj tash, o paloshpirt
bashkë me mua mundesh me pritë,

po s'kam buzëqeshje, të mira fjalë
as premtime për ditë më të bardhë!

N'se m'kupton, tash mbylle derën;
thonjt nga llaku der'sa t'më teren!

DUDIA E KOHËS SONË

Nga dritarja e dhomës
një leshralëshuar
shikon e shkujdesur
fort e përmalluar;

duart vë në gjoks,
gishtat thyen e luan,
ngjethje guduliste
trupin ia kapluan.

Burri na i iku
për punë në dhe të huaj
dhe të holla "shpirtes"
i quaj në dy-tre muaj;

i çoi dhe ca vegla
që kjo i la në podrum,
-S`dua,- tha,- hekura t`ftohta,
jetën dua unë:

jetën me bashkëshort,
jetën me fëmijë,
dashuri të ngrohtë
të kem në timen shtëpi,

prandaj rri në dritare,
s`e fsheh, kam siklet,
mbase si qyqani,
atje larg në kurbet;

s`di, sa mund të durojë
njeriu në këtë mënyrë
vallë, si t`i gjendet qarja
këtij fati mynxyrë!

FRYTI FLAKË E DASHURISË

Në krah të jetës gjendet pema
nga vjen shpesh një fryt me vlerë,
që s`bie në tokë si frytet tjera
po rri n`ndjenja, shkrihet në erë...

hyn në zemër, hyn në gji,
lehtas, qetas pa u ndi...

atbotë prore njeriu ngjethet,
nxehet, skuqet, flaket, ndezet
mplekset kështu në këtë mbretëri
që i sjell gaz e fërfëri,

fërfëri dhe herë-herë pak gaz
që ndez zjarr e hi s`lë pas...

Ky fryt ka fara magjepse,
herë të ëmbla herë të tharta
dhe nga këto forca tërheqëse
bëhen t`athta, bëhen të flakta;

bëhen të flakta kuq e verdh
të rikthyeshme verdh e kuq,
po si flaka mbi kashtë të lagët
që të molisin, të lënë palmuç...

të lënë palmuç, të lënë të shtrirë
veç për të dobtit që janë të mpirë
se për të fortit me karakter
janë këndellje, stinë pa vrerë!

Stinë pa vrerë, stinë pranverë
po ku është, vallë, a vjen ndojherë?!

AH KY SYRI ROMANTIK

Ku puhia përkund përrallat,
ku shikimi s`fsheh andrallat
atje dua të jem.

Ku burimi shkep beharin
ecja ku e josh udhëtarin...
ku sorkadhet shlire vallëzojnë
ku erëmirat këngë vargojnë
dua të kem ferkem.

Ku cicërima e ka gurrën
ku qesh zogu bashkë me lulen;
unë andej drejtoj shikimet
anë andej synoj premtimet
atje dua të jem.

Mu në pyllin romantik
që e shoh e në çast më ik;
ku epi e lyra u shkri në të,
atje ku thonë magjia flë
atje dua të gjej mjaltim.

Atje si n`malin Parnas
ku u dliarka t`idhët e lotit
dhe u shëruakan plagët e motit...
atje dua të gjej galdim!

Atje ku dashnorët shpirtyrryer
gjejnë ilaç për shpirtra të thyer,
ku orë e zana n`vallëzim bredhin
ku hareme qiellit zgjedhin
për jetë të jetëve dua amshim!

FJALË E MJAKË ODASH

Po ju them ca fjalë katundi,
jo burrni e mësim kanuni,
se këtij tash s'ia rrahin rrathët,
e kemi lënë si kacë të zbrazët...

përparuam ne s`po mahit`mi,
por me ju djem pak po çudit`mi,
jo pse mësoni në fakultete
dhe pse po bëhi tzot për vete,
po pse s`po kini më shumë taktikë
kur po ju fërkojnë me politikë!
kur po ju shtinë me sha katundin
që me bërllok po e flliqka lumin!

kurse ne boll mirë sot jemi,
edhe të drejta boll shumë kemi:

...Kemi shtëpia e faltore
kemi gurra, kemi vorre;
jemi të fortë, vend bukanik
tagrambledhësin hisenik,
sadaka japim tepricat
për tatim shesin buallicat!

Po në qytet kemi pushtetin,
këshilltarin, deputetin
që s`u del kohë me ardhë te ne
se tepër shumë punë po kanë atje!
Kemi ndonjë çifte si martina
për shojshojnë, për egërsina!

Ndodh që të thatit t'na lë shkret
herëherë breshni po na vret,
po na mbesim gjallë se gjallë
shesim-blejmë mallë në pazar:
kush me kalë, kush me magar
kush me qe, yrrneq parë-parë!

Vërtet, të madh e kemi hallin
për tregtim kush gatit mallin,
po kur s`po bëhet bereqeti,
rroftë kurbeti, selameti!

Njëmend gratë pak u shtrejtuan,
por ne hiç nuk u dorëzuan,
sepse dihet për gra të mira
shesim tokë, rendisim lira!

Prandaj ju djem mos u gajloni,
po veç këndonit e jetë gëzoni
po te e fundja mos shani sheshit
pse më shumë s`po i japim shtetit;

mos u bëni si do "flokça"
që jetuakan veç për loçka
dhe s`u ha palla për katundin
thonë, ne vetë ta hjekim shkrumbin!

Mos të harrohet një fjalë të vjetër,
s`di a është e shkruar n'letër,
se pa katund kush e do shehrin
herët a vonë ka me ia pa sherrin,

MËMA HAXHIKË, NUSJA LLATINKË

Tri vjet ndenja në kurbet,
derdha djersën në tjetër shtet,
mbi dhjetë orë punoja në ditë
se pa punë asgjë s`sheh dritë!

Mjaft me mund kurseva të holla
që në dhe tim, t`kryejë ca nevoja:
të gjej një nuse, të ndërtoj shtëpi,
që gjithkush t`më marrë lakmi.

Por kur mbërrina në fshatin tim
t`ngurrojë bota pa dyllim,
akraba, dosllarë... stërbija,
sa "miq" kisha nuk e dija,
vinin, shkonin, qanin halle
shumë prej tyre lypnin pare!...

-Më kanë bezdisur, shumë pa masë,
i them hoxhës, pas xhumasë!

-Hua s`jepet në këtë zaman,
me mallë tënd bëhesh dushman,
dëgjomë mua, imam më ke,
pa imam s`hyn kush në dhe,
hallall mall, kush ka, mëson zoti,
ai që vran e kthjell që moti,
le ta çojë babën në haxh,
ka shumë sevape, bëhet paç...

-Po ti e di, baba më ka vdekur,
them, ka vjet jetim paç mbetur!

-Po ai ngjallet, në Qabe del,
n`bëfsh gajret e i çon "bedel".

S`po e zgjas, më në fund pajtova,
"bedel" hoxhën e "emnova"!
Kur e pashë se fikë se fikë
nënë thashë, po e bëj "haxhikë".

U gëzua nënë, u mbush shënd,
-Lumja, t`kam hallall, plot mend!...

Më doli nami, m`u rrit "morri",
por dorënjësije t'hajrit s`më doli;

m'lypnin hupca pa hesapë
kështu dhe natën ma bënë vapë!

-Haxhi baba, mëmë haxhesha,
gajret vetes mjaft i ngjësja;
për na rrofsh e për "pirolla"
i bëra paret rrush e molla!...

Toka djerr mbet, shtëpia nxirë,
por, më në fund, shpëtova mirë:
ika sërish kurbetin mora,
më punoi krahu, më punoi dora.

Tash unë djali i "haxhivarrit"
që për bishti i zbrita qarit,
bëra bë, në këtë dhe të huaj
"lole" më s`i bëhem kuj`
dhe i thashë nënës "haxhilleshë",
shit tokë-shpi, bëri psheshë,
se atje njëherit s'kam pse vi,
se këtu gjeta jetë, rehati:
gjeta nuse një llatinkë
që punojmë bashkë në fabrikë;
sot dy javë kam të bardhë orën,
prifti në kishë na vë kurorën!

Të fala pra nga djalë-hasreti
që "selamet" i dha kurbeti;
ndoshta, Zoti, i qofshim falë,
do të na kthejë në rrugë të mbarë,
në rrugë të dritës për në Atdhe
me bë shpi e nuse të re!
N'se do Fati e kthehem n'shpi
së pari veten do t' bëjë "haxhi",
s'do të punoj pa plan, pa mend
të gjitha punët po lypnin rend!

LOJËFJALËSH FILOZOFORE

Si të kesh si mos me pasë
Shpresëmadhja s'të lëka n'dërrasë!

Si me qenë si mos të jeshë
S'është si loja "qesh e ngjesh"!

Zot me i dalë a dili zot;
Guximtari s'ka të zi mot!

Flisni burra me folë në daçi,
S'është si pitja si kulaçi;

prin oghiçi, jo çfarëdo dashi,
mjer i holli, lum i trashi!

Kush po jep, për të dhënë s'ka kush;
Kokërra e shpinës s'shkruan rabush!

Filozofi zë flet dëlirë:
Vendi-sendit, kohë-hapësirë!

Me qenë jam, me pasë nuk kam;
kur s'do të jem, do të kem tamam,

se kjo trans-lënda me idetë:
kohë hapësirë ka mot e jetë!

Filozofi, në fund, zë pvetë:
Miqtë a i ruan pitja me petë??!

Dijemadhja me dashuri
në fund të barkut pushon, rri;

kryet e thatë dashni s'duron
fara e mirë nga miu e pëson;

dija ngjyer me politikë
rron si macja në fllanik!

DEPUTETIT VETERAN

-A bën, shok, ta shtroj një pyetje,
po të mban populli si zogqyqe:
me zjafete, n'hell rrun'za shyte;

kurse ti tash njëzet vjet
në pushtet si deputet
kurrnjë të mirë për të s'po e flet

s'flet për të padrejta, më shumë liri
për punësim, shkollim, milici,
populli, vallë, pse të zgjodhi ty?!

-Mor djalosh, shok a kodosh,
këso farë punësh fort mos i shosh
më mirë shëndosh rri se balosh;

deputet s't'bën popullata,
po ndonjë shok nga Federata,
që ka nam e duar të gjata;

po duhet baza me taprak
dhe hyzmet me i bë ngapak;
ndryshe mbetesh sidështak!

vërtet, kombësinë përfaqësoj,
po s'kam për të me llapë me gojë,
krejt çka thonë unë i dëgjoj;
syvesh rri, numrin e kam,
besa e zotit, jam tamam
tjetërkënd e kam "imam";

a merr vesh ti a s'merr vesh
gjerat s'duhën bërë përshesh
mos pret, vallë, një flakaresh!?

Kur kam qenë unë djalë i ri
baba m'dha një mësim n'xhami:
që s'harrohet deri n'pleqni:

pas nijetit, qëllimmadhit,
veç me u lidhë mbrapa imamit,
kryhet vetë farzi i namazit;

ai bën lutje ti ndëgjim
e n'fund thuhet veç "amin"!
kështu është puna dhe n'skupshtinë!

E për liri të drejta, t'padrejta
janë këngë të reja a të vjetra,
vlen pararendësja a duhet tjetra

tjetërkush bën kontrollim
Komiteti me Sigurim
që s'lënë hiç me huç drejtim,

kurse ne në Federatë
mbikëqyrim çdo situatë
dhe marrim masa me fushatë!

Ne bëjmë politika të mëdha
nuk gjuajmë zogun për hava,
ai i pjekur vjen, pa dua;

me politikë t'egër e t'butë
gjithsekujt ia ulim trutë
pa ngarkuar ia shkarkojmë drutë!

Dhe me dije shumë e me dredhi,
ne zëmë lepurin n'gjumë kah rri,
e bëjmë meze për qejfli!

Prandaj ti o djalë azgan
në daç me mbërri si veteran
mos stërpik si patlixhan;

së pari merr dorë në pushtet
pastaj në parti, në komitet
siguroji vetes imunitet,

ndryshe rri, them, para qeve
mos dil si mëzi para pele
se bën veten peshk n'fultere!

Je i ri sherr s'qenke mbushur,
ku të prekë gaca të çon ushul,
punët e shtetit s'duan t'përpushur!

SA ÇUDI, SA ÇUDI!

(një udbash oficiel)

Haj medet e sa çudi,
çka na bënë disa të rinj:
papandehur na vunë brirë,
ngase shkelën mbi çdo të mirë:
vallë, pse u hodhën në demonstratë
pse na shtuan dhe këtë lëngatë!
tue pasë bukë cullën me ngi,
tue pasë epshin ku me shfry?!

Sa çudi, them, sa çudi,
po kush dreqin i ka shti:
me na nxi vëllaznim-bashkimin,
me na gjysmue përparimin;
sistemin tonë vetëqeverisës
që n'botë shitet si yllndritës,
vallë, pse u hodhën në demonstratë
pse ditëbardhën na bënë natë?!

Sa çudi, them, sa çudi,
qysh na hodhën këta të rinj,
kur ne u sollëm goça të reja
që t'u zbusim shpirt e nerva
që t'u pëlcasim perden e ballit:
të fanatizmit e të moralit
e këta u hodhën në demonstratë
në vend fëllim zgjodhën shtrëngatë?!

Sa çudi, them sa çudi,
çka na bënë kështu këta të rinj
patëm shpresë t'i përvetësonim
kombësi, fe që t'i harronin,
po ata dolën gacambuluet
pakënaqësinë e shprehën shpluet!
vallë, pse u hodhën në demonstratë,
pse na shtuan dhe këtë lëngatë?!

Kush i fryu kësaj faqezeze:
propagande të nënëdheshme,
ku është pushteti, ku partia
si na u prishë kështu rehatia;
kanë shumë faje do me diploma

qysh s'i çuam krejt në KaPeDoma,
po i lamë sall me vetëkritikë
dhe prap i ngatërruam në politikë,
na shfrytëzuan dhe krejt tinëzisht
axhamive ua bënë me gisht
që të hidhen ne demonstratë
që të na shtojnë dhe këtë lëngatë!

Tash si të mbrohemi mirë e di:
me pushtet e me parti:
të përdorim kmesë e sharrë
druj e pemë t'i marrim mbarë,
s'do të lëmë vend më për pendesë
disa n'turrë, disa n'harresë (!),
e kush të mbetet të mbledhë mend
mos të cenojnë më ligj e rend;
disa rrugëve pa punë të lihen
kurrqysh n'shkolla t'mos përvidhen,
Se vetë e thyen qafën n'shtrëngatë
kur u hodhën në demonstratë!

ME URDHËRESË: ARSIMIT FSHESË!

Një urdhëresë: arsimit fshesë,
të zbatohet pa vonesë;
është fushatë me porosi:
në arsim fshesa sa ka hy
dhe pikë së pari si detyrë
është kuadrin mirë me dliirë;
me pastrue drithin nga egjra,
pa lënë anash masa të egra;
dhe nën maskë t'riorganizimit
të futet metoda e filtrimit,
kurr gjë mos me lënë gafil
të rimbikëqyret çdo profil;
kështu veç fisniku më besnik
mund t'mbesë i "kyçur" n'politikë;
në këtë diferencim të vërtetë
besnikëria sheshet vetë;
vetëm kështu mund të frymojmë
jetëfatlumen ta gëzojmë?!

Pra, jashtë të flaket çdo ithtar
që e ndjen veten pak atdhetar;
tashti ligj, rregull s'do të këqyrim
me qëndrim varrët do t'i mbyllim;
kush lyp ligje, jo qëndrim
n'këmbë e n'dorë me i dhënë jashtim,
përrjashtim me vendim të partisë
garantuese e demokracisë (!);
gjithsekushi mirë le ta dijë
se këtu i thonë Jugosllavi
se këtij shteti i thonë Serbi
dhe këtu mikrobi s'bën me hy
se sherri i vogël i madh pjell
nëse mëshirë tregojmë kësaj herë?!

RRËFIMI I NJË PORTIERI

Pa dëgjoni, o shokët e mi,
t'ju rrëfej vetëhistori,
para se me shkue n'ushtri
kam qenë unë çoban me dhi
njëherë me dhi, pastaj me dhen
kam ruajtë bylykun me katër qen;
kam vjelë pemë, kam mjelë plleja
kam ëndërruar për çika të reja
dhe n'kullosa sa me u kënaqë
kam gjuajtë ndonjherë me kapsollaçë
po në ushtri tue shërbye pa sherr
mësova lojën "jep e merr"
me një punë që e bëra "fer"
më lanë me gjuajtë me revolver,
pastaj zura shok një oficer,
një oficer, një gjeneral
që hiç pa kurs m'bënë *desetar*;
besa më futën edhe në parti
e vërtet, kjo s'është mahi,
se unë një herë si djalë besnik
për ta veç që s'e lashë kryet:
kur dikush si nëpër terr
ata deshti keq me i therrë
unë i shpëtova për një qime
se qëllova si prapa shpine;
kështu i kapa sulmuesit në bef
dhe i shtrova si pata qejf;
kishin qenë shkelës të kufinit
armiq të mëdhenj, spiunë t'*llatinit*!
Ky qe shkak që më dhanë "nagradë"
dhe m'shkoj emri në "shtab-brigadë".
mos me zgjatë, mor miku im
e çmuan nalt timin guxim.
...Posa u ktheva nga ushtria
rroftë njohësia, rroftë shoqnia!
menjëherë me gjetën punë,
më të mirë seç ëndërroja unë:
më caktuan kënde: roje nate
në një shtëpi me dy-tri kate
dhe pastaj më sollën n'portieri
në këtë fabrikë ku më gjete ti.
Tash detyrë kam me përcjellë:

kush po hyn e kush po del,
besa me i përgjue do "tipa"
që po u përzikan n'politika
e për me i dalë zot kësaj detyre
ma kanë nda veçan një zyre:
me alarm me telefon
me lajmërue centralin tonë;
me thënë t'drejtën, s'e kam zor
se po m'ndihmojnë dhe do drejtorë;
tash punoj dhe s'kam mërzi
bash ashtu si me qenë bari.
Dhe tash kam t'vjela e të mjela
po jo pemë as dhenë plleja
po do punë që s'mund t'i themi,
se janë qenishe a punë demi;
po nën krahë t'mi si mjelc e vjelc
do drejtorë po më lënë ngelc,
se ata, vëlla, me politikë
për shumë do punë po kanë taktikë;
nuk kanë frikë, janë mendjehollë
se po dihet, kanë shumë shkollë,
me pasë shkollë dhe unë kam qejf
se një pa dy mund t'bëhem shef;
po m'kanë premtue se një dëftesë
do të ma blejnë shpejt pa vonesë.
E për diplomë, thonë, dy gjsmërroga
me rregull po e lëshueka shkolla.
Kështu po u mbajtkë evidencë
demek, shkolla mos me dalë rrenc,
se për dije, aso bash të vërtetë,
po thonë mësuese është nëna jetë.
Rroftë shoqnia, rroftë njohësia:
se po tejplotësohen ëndrrat e mia!
Tash kam boll të vjela edhe të mjela
besa edhe kënaqje: çika të reja!
që kur si qura humbin në mjegull
më vijnë në zyre m'bëhen petull;
veç mos me u shkrue raport - mungesë
janë të gatshme për çdo ndëgjësë!

NJË SINDIKALIST I SPROVUAR
(monolog ëndërror me vetveten)

Jam shërbyes në të tretën ndërresë
s'jam i kënaqur, po s'bëj ankesë,
se kam parë edhe më keq shumë
sa kam qenë pa hyrë në punë;
të bëjmë grevë një Mendje më tha:
-Me lypë paga më të mëdha.
-Na takojnë -them- na takojnë
djersën tonë po e shfrytëzojnë,
po janë do shenja, duhet me pritë
pa u blue drithi, qysh me u sitë?!
Dihet puna se n'socializëm
s'njihen greva, as grevizëm,
atje ku bëjnë greva, demonstrata
me sa di, flenë në pare të thata,
se pa mallshumë, pa pasë mbulesë
s'bën askush t'hidhet n'rebelesë;
ndryshe me kokë do t'i bihet murit
pa burgji s'ia lë shenjë gurit!
Atje diku në Perëndim,
si më ka thënë një miku im,
kanë bërë grevë e rrebelesë
dhe pse kishim pare për jetesë;
kanë lypë tambël, mish më shumë
këtu as dhallë s'japin askund.
Për këtë me folë, këtu miku im,
ta zënë për të madhe, provokim
se këtu ka fals-demokraci
nuk të mbron ligj, s'të mbron parti;
këtu ka fals vetëqeverisje
propagandë mashtruese, fyese;
thonë, ka të drejta punëtoria
se është shporrë moti skllavëria,
janë pallavra, janë mashtrim
për punëtorët mjegullim,
se n'interes po u prek pushteti
administrata, komiteti
vaj halli për punëtorinë,
krejt e zhveshin, krejt e zhbinë.
S'mbetet tjetër: veç me ruejtë bukën
se ndryshe humbim krejt vendpunën,
se po iu këputë gojës kafshorja

dhe nga uja të kërset zorra;
s'ka më keq, vëlla, merret vesh
se me zor hasmit i buzëqesh;
kur s'ke pare, ore, për te shpia
nuk të do gruaja, as fëmija!
Këtu ne shpresa do të na ringjallet
veç n'se në kryet vetë peshku kalbet!

ORGANI I DHUNSHËM PUNËDREJTUES

Jam organ i dhunshëm, më quajnë "inokos"
unë jam i vetëquajturi: "vetë shkruaj vetë vulos"
e kam të fortë mandatin si i vetmi organ
si duket jam vetë ai zoti që "kthiell edhe vranë"

Ju prodhues, dëgjoni, n'se doni rehati,
punoni prodhoni dhe shprehni kënaqësi;
edhe ju punonjës këtu në administratë
kah të kaloj unë le t'u hyjë mandatë,
sepse jam fuqiptot, kam autorizim
cili s'më nënshtrohet me i dhënë përjashtim!

Po ju them krejt haptas qysh më kanë thënë në Qendër
se këtu paska pasur armiq të fshehtë pa emër!
Dihet ku prek armiku s'ka fare demokraci
larvat e keqberësit që n'palcë duhen zhbi!
N'se unë diktoj maskista ashtu sidemagogë
e kam detyrë me i flakë, *sikter*, si bërlllogë
se kështu ne na mëson vija e fortë e Partisë,
e Vetëqeverisjen e Jugodemokracisë.

Ne armiku në gjumë kurrë s'ka me na kapë
se nuk hamë karremi si ai peshku krap,
sepse vendi ynë ka një vetëqeverisje
që para botës së mbarë sot ka dalë siprise,
por për armiq, dihet, ruajmë veç diktaturë
që kuj njëherë t'i mëshojë ai mos t'ngrihet kurrë.

Prandaj ju punëtorë që ju mban idarja
luani duartë në prodhim që të na luajë dhe parja;
Ta keni të qartë të përbashkëtin interes:
punëtori pushteti kurrë s'hynë në një thes,
punëtori është për punë, shteti për sundim
kur shteti s'përdor dhunë, punëtori ka lehtësim,
po dhunë nuk do të ketë veç kush është lojal
që për të kujdeset dhe ligji i mirë social,
ndryshe për rebelues, për prishës qetësie
shteti përdor dhunë pa asnjë pikë mëshire;
kështu ju fola haptas si organ *inikos*
pa ju bë fort lajka, pa jua lye me kos!

Këto që ju fola unë sa për njohje të parë
i bëj mirë me dije dhe ca kokëtrashë shiptarë
që nganjëherë kanë prirje me zjarr ata me luajtë
dhe për këtë qëllim, kujtojnë se i ndihnin të huajtë?!
Po i huaj, karajfila, këtu s'mund t'i fusë hundët
se ne vetë jemi zotër, me hu i ndreqim punët!

APELI I NJË "PEDAGOGU"

O ju nxënës e studentë
eni n'vete, mblidhni mendt
mos u bëni si të trentë;

mos dëgjoni do axhami
që ju ftojnë n'luftë për liri
dëgjona ne që mbajmë urti;

mos dëgjoni do kritikuca
që ne po na quajnë derrkuca
që ulim kokat sikur struca;

sa herë masa ha dajak
e ne s'i dalkemi zot aspak
dhe s' na brejtka ndopak merak!

Vërtet, ne s'jemi aq ekspertë
që të përmbushim çdo ofertë
po dhe fasulen s'e hamë aq t'nxehtë;

ne përherë japim mësim
stoikisht t'qëndrojmë në shtrim
se, thonë, durimi sjell fitim;

vërtet marrim ndonjë mangërr,
herë si andërr herë si zhgjandërr
po jetojmë veç sa me hangër;

se me punë tonë që bëjme për ditë
bash asgjë s'mund t' qesim në dritë,
po s'e kemi ndërmend me u mbytë;

prandaj, them, kujdes ndaj shtetit,
urt' e butë ndaj Komitetit
promotorit të progresit;

se dhe ne si intelektualë
fshehim brendë t'madh ideal
po e mbajmë s'e lëmë me dalë;

pra, besoni nxënës, studentë
se ne japim mësim të vërtetë:
n'razi t'shtetit për me ndejtë;

se ndryshe na pret biruca
na bëni sherrin, ne, mor pusa
se luani s'gjuan hardhuca;

dihet shteti, mor kokërrosha,
kërkon mësues, besa profa,
me i dhënë masës të rëna të forta

që të mos çohet kurrë për jetë
me lypë liri e ndonjë të drejtë
si për flamur e ndopak pushtet!

ZHGËNJIMI I NJË DELEGATI

Shokë punëtorë zgjedhës të shtrenjtë
lëmshit tonë iu këputën penjtë
na humbi fiija, përfundim,
kërkesa jonë pësoi refuzim;
sa u paraqita në atë kuvend
dhe kërkesën e vura në rend
shi kur thashë se *punëtorja*
po kërkon rroga më të mira
se djersën e saj hiç pa meritë
administrata po ia grabitë,
menjëherë më gjeti belaja:
me bërtimë m'u ndërpre fjala
se ajo halla që te shuli rri
-Ndalu,- më tha,- ti djalë i ri,
mos i mësho kokës për murit
s'e luan macja kryet e bullit,
me folë kështu në konferencë
duhet të keshë dhe kompetencë?
Ndal mos fol, ne, po të thomë
që kemi nga një copë diplomë
dhe që konstatojmë si specialistë
se ti po bën shkelje të shumëfishtë;
si punëtor ti s'ke detyrë
punët e hallkur me mbikëqyrë
punëtorët veç duhet me prodhue
e bashkë me shtetin me fitue
se mos me pasë shtet e pushtet
administratë e komitet,
gjithçka e mirë do t'mbetet shkret
mos me i ndëgjue kurrë do rrenca
horra, pisa, besa vjedhca
që synojnë të bëjnë veç tollovi
dorëzat shtetit me ia përzi,
ndryshe, tërë bota mirë e di
se fitimi bëhet me tregti
dhe buxheti e tregtia
s'kontrollohen nga punëtorja,
po nga shteti e administrata
nga ata që i kanë duartë e gjata,
ti me fjalë bërë delikt
me dijte fajin do t'bjerë të fiktë!-

Kështu me të butë më shumë me të egër
dikush më thirri në një zyre tjetër,

ku mori pjesë dhe një hetues
me marrë vesh: a m'ka "verbuar" kush.
Në fund më tha:-Shoku delegat,
mbase ta falim këtë kabihat
n'se n'shenj respekti për pushtetin
e revokon vetë imunitetin,
e dorëzon në bazë mandatin
le ta rizgjedhin delegatin,
ndryshe organi do ta lajë hakun:
më butë shpinën sesa barkun?!

Pra, ja, shokë, shyqyr shpëtova
se ç'ka më ndodhi ju tregova
delegat zgjidhni një tjetër
jo të rinj po ndonjë t'vjetër
që i di të drejtat jo si n'letër!?

POLITIKANI PA FENER!

Qeshë pa cak e pa fener
rrugë kërkova natën terr
me instikt, me intuitë
pa pasë sens në politikë;

papandehur më zuri stërkala
e lumit të madh nga kaloi vala
unë në vend se të fshihem në çuba
vetë iu ngjita, vetë u çulla;

Politikë, moj, politikë,
thonë je arti më praktik,
më praktik dhe më taktik;
fitimprurës, por me rrezik;

mua më joshe mirë njëherë
në valët e shpejta jep e merr,
por më vonë mësova diçka
që të bën me qeshë edhe me qa;

je vetë shtriga me shumë krena
herë ke dimna herë ke vera;
politikë je nënë e lojës:
e mashtrimit, art i plojes;

art i të mundshmes bukuri
art i të pazhdukshmës llahtari;
art i mirësjelljes së punës,
art i arsyetimit të dhunës;

art i hapit të vrapit të kohës
art i mohës dhe i pohës;
art që të ngritë në pediestal
art që të ndezë si eshkë me strall;

art që burrit ia nxin fytyrën
art që ia ndërron shembëlltyrën!

Politikë moj dritë n'fener
që më joshe si fluturën në terr
dhe kur desha jashtë me dalë
nuk më lirove damarësh pa m'kallë;

politikë, moj frymë vigane
art i vetëqeverisjes së madhe;
politikë e rradhëve tona
që ushton shpellave si jehona
dhe nuk kapesh as nuk shihesh
porsi zhurma e dreqit ndihesh;
dallgë e valë shpesh të duket puna
posi detin kur kap furtuna!

Politikë, mor pus i gjallë
lehtë me hy shumë zor me dalë,
unë dështak në fund të pusit rashë
si në klub të dreqit ndonjë vashë!

KOVAÇI PUNËDHËNËS

O shok i vjetër, farkëtar
ne që njihemi shumë më parë
a të kujtohet në burg të zi
kur më sollën të gjeta ty,

atëherë prangat m'i pate heqë
një punë sot a po ma ndreqë
vëllait tënd me i gjetë punësim
se një kohë isha në "riedukim"!

-He mor vëllaçko, të tregoj unë
shpeshherë fati vjen me dhunë,
shokun tënd që dridhte shufra
që iu patën bërë duart si putra

e kam kryepunëtor në kovaçhanë
mbase do ai me të pasë pranë,
ne te dy jemi privatistë
punëdhënës zori të shumëfishtë.

Më parë punësova një piktor
pak më herët një profesor
që kanë marrë dhe nga një diplomë
sa ishin atje në KaPeDom!

Çfarë zanati ke marrë, më thuaj
t'i them shokut ku të t'gjuaaj.
-Inxhinier s'jam, as mekanik
di të shkruaj vjersha, more mik,
mund të qes këngë për farkëtore
tjetër gjë s'më shkon për dore?!

-Ç'të bëjmë me ty, mor këngëtar,
për këngë koha s'është e mbarë,
po pasi qysh moti jemi miq
po të marrë me fry në rrëshiq

dhe aty, thonë, ka ritmikë
sikur vjersha për muzikë;
ta kam gjetë tamam zanatin
me punue qysh ke takatin!

Po s'më the një fjalë o mik
pse prap rrëshqite në politikë
a zunë sërish me atë zog të zi
që rri në bojëgjaken sishami?
-Po vërtet, po tash më shumë
lypa fatin me furtunë!

(Hej dynja, dynja e gjorë
inxhinierë, mësues, profesorë,
krejt pa punë po sorollaten
lypin qarje s'kanë ku t'kapen,
po pse po hyjnë laknave, o zot,
se kështu hall s'u jepet dot!)

-Pse s'po rrini urtë, mor djalë,
druaj po më kap dhe mua zarar,
pse s'po këqyni bukën me ruajtë
se kështu mushka ua rrëzon drutë?!
Këtu tek unë mos bëni gafë
se sall veten s'e merrni në qafë!?

BABALOKU PEDAGOG

Jam bab'lok, plak me përvojë
të rinj e të reja di t'i mësojë
jo teori si në fakultet
po punë praktike siç di vetë;

Tash një çështje bashkë po e prekim:
qysh mundeni me e njoftë pacientin
pa e prek hiç me i gjetë iletin?!

Pacentë, po e marrim, një çift të ri
që sa ka dalë më vete n'shpi,
duam të mësojmë sa kanë qetësim,
harmoni dhe mirëkuptim?!

Për ta mëson, pra, pa i pyet fare,
veç përgjoi n'derë a në dritare:

N'se ndjeni ngapak shamatë
gruaja flet gjithë me lëvdatë
e n'anën tjetër burri mpron veten,
aty s'kemi punë me të keqen;
kundërthëniet nuk janë grindje
po ua them unë me plot bindje,
pokështu jeta e çiftit të ri
mund të jetë shembull për lakmi;
pak me nguca, djem, por me vend,
lumturia rron, shton shënd,
ndaj aty mund të hysh për kafe
besa për qejsh dhe me zgjatë llafe.
Po nëse në shpi ndjen piskamë
ndonjë ofshamë, besa rropamë
në atë raste pa u hamendë
merr policin futu brendë,
se aty jeta është mbushë vrragë
dashurisë i kanë dhënë plagë,
po n'se krejt nuk janë këputë penjtë
dukja juaj do të jetë e shenjtë,
sidoqoftë, duhet ndërhyrë
që të ndahen punët më mirë:
për mbarëpaçe a për kulaçe
për një shpi a dy konaqe.

Po nëse në shpi shamatë nuk ndihet
se është mbrenda çifti dihet
e aty mbretëron heshtje varri
aty dashninë e ka djegë zjarri
në atë shtëpi shko bashkë me mjek
pa e mbushë pushkën me fyshekë!
atyre u duhet shërimtore
shumë ilaçe, mjeku prore!

* * *

Këtë ua mësova, unë babaloku
që s'kam kryer shkollë pedagogu
po i kam shëruar shumë varrë në jetë
me fletë dezi, me kryp e qepë!

Prandaj ju të rinj pas martesë
s'mund t'ju mposhtë kurrfarë ngatërrese,
nëse zënkat paksa i përpini
dhe me takt dashninë përtërini,
ndryshe policë a mjekë pa thirrë
do t'ju duhen në sahat të vështirë!

PROFESOR, FALSPUSHTETAR

Profesor, pushtetar
je me emër bajraktar
jepna dhe ne pak pushtet
siç kërkojnë disa studentë.

-Ç'pushtet duan ata studentë
kur i mjeri s'kam as vetë!

-Profesor, pushtetar
që ke zyre, sekretar,
jepna dhe ne dije, liri,
se ndryshe do të pësosh dhe ti!

-Çfarë dije lypni ju,
kurrfarë dije s'shkrep këtu.
E për liri, mor kaçadrena,
ka në fushë të lirë, jo këtu brenda?!

-Profesor, mos fol si i mjerë,
pushtetar je, poshtë mos bjer,
ne të shohim shumë të madh
kah kullot shlirshëm n'livadh?!

-Vërtet, jam t'zotnisë livadh
argat i vogël, jo i madh,
se zotnia më ka n'pasqyrë
punën time po e mbikëqyrë?!

-Profesor, mos u stërkeq,
thuj, për hunde kush të heq,
kur ke postin pushtetar
pse s'trazon "miq e dostllarë"!

-Jo, s'po besoj se me doemos
deti duhet me u bë kos?!

-Detin kos, o profi ynë,
kurrë nuk bëhet me ndejtë në tym,
andaj shfytëzo' postin, mor tucan,
mos prit të ramet me tupan!

ARSIMTARIT KUJDESTAR!

Arsimtar, or arsimtar,
që të kam pasur dhe kujdestar,
s'meriton lavdatë me marrë
falenderim, as gjë për farë,
pse na thoshe të jemi të mbarë,
pse na thoshe mos me vjedhë,
shoqishojt mos me ia stërhjedhë;
mos me sha e mos me rrejtë,
po me u sjellë si njerëz të shenjta,
me mësue shumë, mirë me ndëgjue
n'shkollë e n'shpi me shëmbëllue;
na ke dhënë dhe të tjera mësim
që prej të gjithave patëm pësime!
Mbase më mirë do të kishte qenë,
pa mësim të tillë ne me na pasë lënë,
po t' lyer me vaj si pelivana
e mos me ndejtë çuç, si qyqana;
Vërtet, njeriu në këtë jetë
fakt shumë dije duhet të ketë,
po dikush kur të mban nën zgjedhë
atij duhet disi me ia hjedhë:
me rrejtë duhet, besa me vjedhë,
me të s'bën me u sjellë me tutë
mos t'shkojnë punët gjithë urtë e butë;
në këtë shoqni, o mësuesi ynë,
me u sjellë si njeri hiç nuk vyen;
pa kurvnue e pa u bë horr,
kurrë sukses s'mundesh me korrë;
pa u bë drejt e përtej drejt
për karshi s'mund t'i rrish të keqit,
se jetojmë në botë me të fëlliqt
ku s'ka nder, ku s'njihen miqt;
gjithkush të zhvoshë hollë e trash
"modernizëm", krejt mishmash?!!
-E vërtetë, gabime kam,
pse u bazova veç në program;
po kam thënë, or biri im,
ka çdo rregull përjashtim.
Janë shumë fjalë s'fliten me zemër,
po herë me mendje, herë me thembër.
Do punë s'mbështeten sall me takat,
por për të gjitha lypset zanat!

MËSUESIT IDEALIST

Ti mësues plak kaskanli
e sheh fatit si i ke pri
krejt dynjasë i ke dhënë mësim
dhe prap n'vete lë shqetësim?!

Vetë po e sheh tash, more gjysh,
se pleqninë s'e ke kurrqysh,
s'ke ndër xhepa asnjë dysh,
s'të bën hesap kush sa një këlysh!

Shumë të rinj s't'njohin fare aspak
dhe pse ti për ta behesh merak
dhe shpesh flisje tue belbëzue
për do zemra që duhen bashkue?!
Tash pishman mos i ke rënë
se qyqarë shumë kishin qenë,
kanë një gjuhë, kanë një farë,
po s'ngrehin kurrë për të mbarë?!

-E vërtet, bir, shumë e vërvërtetë,
këtë kurrë mendjesh s'kam me hjekë
pa u paqtue zemrat arbnore
qenqe jetë do të kemi prore:
si këndej si andej gardhi
sa n'sundim na mban bastardhi.

Mos harro, o djalë i mbarë,
liri s'ke si hyzmetqar
edhe në të mblofshin me dollarë!?

Liria djalë s'matet me pare
me karrierë as tjetër fare
ajo matet me shpirt krijuesi
ajo matet me fjalë mësuesi.

Dhe pse sa vjet vuaj katrahurë,
mësim-besimin s'e humb kurrë.
Shpresa, thonë, është armë e parë
kur për të punon rinia mbarë?!

Bashkimi i mendjes, o i miri djalë,
është më i shtrenjti ideal
mua shpirti s'ka me më dalë
pa i pa t'rinjtë nga ecin mbarë!?

MALLTREGU I DIJETARIT!

Një dijetar në qytetin tim
doli në treg për reklamim
të përuroj të vetin thesar
të përmbledhur me dy-tri fjalë:

*mall i rrallë, mall që hyjnon
çdo i ri duhet ta bëjë pronë!*

-Hahet, pihet malli yt
a bën mirë për shëndet për fyt;
folë a mbathet, mbase vishet,
a dëgjohet, folë a shihet?!

Kështu e pyetnin pa pushim
dhe përgjigjja vinte shqim:
-Jo, s'është piye, as ushqim,
më shumë vlerë ka mallim im;
s'është veshë-mbathë, send me u pa,
më shumë vlerë se të gjitha ka!

-Malli yt, vallë, a jep para
që s'e qet sheshit me pa?!
-Mos vallë malli yt me vlerë
e ngrit njeriun në karrierë!

-S'jep para as s'ngrit n'karrierë,
po ka edhe më shumë vlerë,
çdo i ri atë duhet ta ketë
se ka vlerë për mot e jetë!

-S'po ta duam, s'po ta duam
thanë, njerëzia, edhe shkuan!

Dijetari plot zhgënjim
u mbyll në vete në mejtim!

Një mësues plak, mirë e përgjoi
dhe qëllimin ia kuptoi,
në fund zotin dijetar
kështu e pyeti për thesar:

-Pasi paska aq shumë vlerë
para s'jipka as karrierë
as s'na thua çështë atëherë
malli yt që të mbeti në derë?!

*-Thesarmadhe për rininë
është të përqafojë diturinë;
diturinë e Hyjit të paqtë
jo t'satanit që ngreh mbrapsht!*

-Mirë e ke, mendja ma kap,
k'saj t'vërtete vulë t'i jap
po njerëzia mor fakir
do qartësi edhe më të mirë;

së pari ai do haje, piye,
madje veshë e mbathë me shije
sigurisht para, karrierë
dhe dashuri të lirë, përherë;

Prandaj ik mbyllu n' brendi
me këso fjalësh s'dilet në qarshi;
jo se s'ke të drejtën e madhe
po rinia s'të kupton fare!

Puna-dija, vërtet, stolis
është tipar i perëndisë;
jo paraja, jo karriera
se ato s'janë aq të vlera

se lëkundje-tundje nëse ngjajnë
të gjitha tretien, ikin, çajnë,
ndërsa dija të çdo njeri
mbetet më e vlefshmja pasuri?!

Jo veç të rinjtë, o dijetar,
po s'të kuptojnë as ca shkollarë
dhe pse prijnë në fakultet
dijes pak po i bëjnë hyzmet,
më shumë i falen pare-karrierës
gaz-dashnisë, afshit të pranverës
se sa dijes që s'matet me okë
që ka rrënjët: në qiell e në tokë!

SHËNIME PËR AUTORIN

Nuhi VESELAJ u lind në fshatin Reçan të Suharekës, më 20.VIII.1933. Shkollën fillore e kreu në Suharekë në vitin 1948, ndërsa Shkollën normale në Gjakovë, ku maturoi më 30.VI.1952.

Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe e kreu më 23.IX.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe më 23.IX.1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 3.IV.1980 mori gradën: magjistër i shkencave filologjike, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 24.XII.1992. Punoi në arsim (shkolla): Mushtisht, Grejçec, Muzeqinë, Ferizaj, Zllatar, Tankosiq, Prishtinë. Pasi e larguan nga arsimi një kohë punoi referent në "Partizanski put" të Beogradit - filiala në Prishtinë, ndërsa u pensionua si lektor-përkthyes në uzinën "Amortizatorët" të Prishtinës. Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë e të Rinj, me seli në Tiranë.

Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye të ndryshme s'ka mundur t'i botojë të gjitha dorëshkrimet.

Deri tashti botoi këto vepra:

1. *Miklime* (vjersha) (1967) (ribotim) (1997);
2. *Rrezet e Ylberta* (vjersha) (1971) (ribotim) (1997);
3. *Me buzët në gaz* (vjersha) (1997);
4. *Fletë ditari rreth një motmotari* (vjersha) (1997)
5. *Trimoshi* (tregime për fëmijë dhe të rinj) (1997);
6. *Cace e hope djaloshare* (poezi) (1997);
7. *Shfrime nëpër mjegullnajë* (poezi) (1997);
8. *Gërricje në damarët e djalërisë* (tregime) (1998);
9. *Mësime nëpër pësime* (shfaqje teatrore) (1998);
10. *Bulëza të përshenjura* (vjersha të një "babamësuesi" kushtuar stinës rinore), Prishtinë 2000;
11. *Ther me pupël* (vjersha të ngjyera me humor), Prishtinë, 2000;
12. *Vëllimin e parë të veprës gjuhësore "Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit"* (1997);
13. *Paskajorja - çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000

Pritet që nga penda e kërij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha letrare-artistike, qoftë nga ajo shkencore-gjuhësore.

P ë r m b a j t j a :

P a r a t h ë n i e

Parasqarim lexuesit
Dolli me buzëqeshje
Lum e lum...
Nxënësi me veturë
Apsolventi i shkollës së mesme
Oj ti nxënësja e shkollës së natës
Rrugëdalje e mendejehollit!
Brucoshi boshkohor
Një vajzë e emancipuar
Këshillë praktike
Hak për hak
Lojë fjalësh
Miqësi e kushtëzuar
Ah kjo forca integruese
Hobi i një akademiku!
Gjurmimi shkencor!
Mospërfillje
Për lakmi
Shpirti i përgjumur
Filozofia bashkëkohore
Çifti ideal
Bashkëshoqja ideale
Terapia
Ilaçi i dertlisë
Zgjidhje fatlume
Kompliment pa kompliment
Dialog poetikist
Hapet e dashurisë së mpirë
Lotët e burrit
Mendjerënda
Me dy gra
Ah, këto zënkat!?
Sedërgrisura
Frymëzim patetik
Dietë frizere
Letër mikut
Një i anketuar
Hallëfshtarka
Apeli i një politikani të lartë
Lutja e një drejtori

Hallet e një sekretareshe
Dudia e kohës sonë
Fryti flakë e dashurisë
Ah ky syri romantik
Fjalë e mjakë odash
Mëma haxhikë, nusja llatinkë!
Lojëfjalësh filozofore
Deputetit veteran
Sa çudi, sa çudi!
Me urdhëresë: arsimit fshesë
Rrëfimi i një portieri
Një sindikalist i sprovuar
Organi i dhunshëm punëdrejtues
Apeli i një pedagogu
Zhgënjimi i një delegati
Politikani pa fener
Kovaçi punëdhënës
Babaloku pedagog
Profesor, falspushtetar
Arsimtarit kujdestar
Mësuesit idealist
Malltregu i dijetarit!
Shënime për autorin